



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel ndihmësakademik me karakter administrativ, specialist jurist, në Drejtorinë Juridike, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, në Rektorat (*DJKKA*).

**Specialisti jurist** është pjesë e sektorit juridik, të Drejtorisë Juridike, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI.

Specialisti përgjigjet për:

- zgjidhjen ligjore dhe teknike të problemeve brenda sektorit në përputhje me përshkrimin e punës dhe mund të bashkëpunojë me të gjitha strukturat brenda dhe jashtë drejtorisë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme;
- në raste mosmarrëveshesh me struktura të tjera brenda UE-së, njofton menjëherë Drejtorin, i cili ndjek më pas zgjidhjen e konfliktit;
- realizimin e detyrave të ngarkuara nga aktet nënligjore ose nga eprorët brenda afatit dhe raportimin e tyre;
- kryen me përpikmëri dhe nivel të lartë profesional të gjitha detyrat që i ngarkohen.

Kandidatët duhet të plotësojnë kritere të përgjithshme e të veçanta për këtë pozicion pune.

### **Kriteret e përgjithshme:**

- Kandidati duhet të zotërojë diplomë të ciklit të parë (Ba) dhe të dytë Master i Shkencave (Msc) ose të barazvlefshme më të, në shkenca juridike. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njehsuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- Të ketë përvojë të mëparshme pune.
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë njohuri të paktën e një gjuhe të huaj të vertëtuuar me dokumentacion.
- Të jetë i aftë për punë.

### **Kriteret e veçanta:**

- të kenë trajnime, kualifikime në fushën e shkencave juridike.
- të ketë aftësi të mira profesionale, organizative, etikë të lartë komunikimi dhe të punës në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në **rrugë postare** për periudhën 04.09.2023– 14.09.2023 dokumentacionin e mëposhtëm:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
REKTORI**

- Letër motivimi për pozicionin specialist jurist;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport mjekësor, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Të interesuarit duhet të dërgojnë në rrugë postare brenda afatit 04.09.2023–14.09.2023, dokumentacionin në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,  
Rruga “Ismail Zyma”,  
Aplikim për pozicionin e punës *specialist jurist*.**

Komisioni ad-hoc do të vlerësojë dosjet e kandidatëve paraprakisht dhe më pas ata do të nënshtohen intervistës me gojë. Konkursi do të zhvillohet në Rektoratit e UE-së, në periudhën 18.09.2023 - 29.09.2023. Kandidatët konkures do të njoftohen elektronikisht brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike për rezultatet paraprake të konkurrimit dhe më pas shpalljen /njoftimin e fituesit.